

VENDIM
Nr. 5, datë 28.1.2014

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE NË QARKUN LEZHË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 28.1.2014, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi (Lleshi)	kryetare
Hysen Osmanaj	anëtar
Klement Zguri	anëtar
Vera Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste në qarkun e Lezhës, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të znj. Mirela Neli.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 91/1 prot., datë 23.1.2014, drejtuar KQZ-së, sekretari i përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Mirela Neli, deputete e zonës zgjedhore qarku Lezhë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 35, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore, qarku Lezhë, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste për zonën zgjedhore, qarku Lezhë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, ka fituar 2 mandate, dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për qarkun e Lezhës, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Mimi Pjetër Kodheli, me numër rendor 2 (dy) Armando Ndue Prenga.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Mimi Kodheli, deputete e zonës zgjedhore, qarku Lezhë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 852, datë 26.12.2013, i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Mejreme Delishi.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, të znj. Mejreme Delishi, deputete e zonës zgjedhore, qarku Lezhë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 1, datë 20.1.2014, i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Mirela Neli.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste në qarkun Lezhë i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Përpara krijimit të vakancës, mandati i përket kandidatës znj. Mirela Neli, e cila i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, në këto kushte në plotësimin e vakancës, KQZ-ja do të duhej të zbatonte përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, duke ia dhënë mandatin kandidatës së radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas deklaratës model 03 “Deklarim për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore”, të depozituar nga PS-ja në dokumentacionin e listës shumemërore të zonës zgjedhore qarku Lezhë, rezultoi se pas znj. Mirela Nelit nuk ka më kandidatë nga gjinia femërore, e cila është dhe gjinia më pak e përfaqësuar. Në këto kushte, KQZ-ja nuk mund të aplikojë rregullin e përjashtimit, pasi emrat e gjinisë më pak të përfaqësuar, pra të gjinisë femërore kanë shteruar.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i kalon kandidatit të radhës, i cili, sipas listës shumemërore për zonën zgjedhore, qarku Lezhë të Partisë Socialiste, është kandidati me numër rendor 3 (tre) z. Arben Ndue Ndoka.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste, qarku Lezhë, z. Arben Ndue Ndoka.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Kryetare: Lefterije Luzi (Lleshi)

Anëtarë: Hysen Osmanaj, Klement Zguri, Vera Shtjefni